



| | |
|--|------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO | |
| Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo | |
| Ministria e Financave / Ministarstvo za Financije | |
| Ministry of Finance | |
| Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kosova / Tax Administration of Kosovo | |
| ARKIVA / AKTIVA / ARCHIVE | |
| Nr. Prot. By Prot. No | 09-06-4402 |
| Data Datum | 26.12.18 |

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave - Ministarstvo za Financije - Ministry of Finance

Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosova - Tax Administration of Kosovo

Bazuar në autorizimet e dhëna në Nenin 3 dhe 7 të Ligjit bazik Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-102 dhe Ligjin Nr. 04/L-223, Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, nxjerr këtë:

RREGULLORE PËR ROLIN DHE FUSHËVEPRIMIN E AVOKATIT TË TATIMPAGUESVE

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i funksioneve, përgjegjësi dhe procedurave që do të zbatohen nga Avokati i Tatimpaguesve, si dhe të drejtat dhe procedurat që tatimpaguesit duhet t'i ndjekin për të adresuar shqetësimet e tyre tek Avokati i Tatimpaguesve.

Neni 2 Roli i Avokatit të Tatimpaguesve

Avokati i Tatimpaguesve është themeluar në kuadër të ATK-së, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të tatimpaguesve të përcaktuara me Ligj, si dhe të ndihmë tatimpaguesit në zgjidhjen e problemeve dhe çështjeve, për të cilat ata pretendojnë se nuk i'u janë trajtuar drejtë ose në kohë.

Neni 3 Organizmi i Avokatit të Tatimpaguesve

1. Avokati i Tatimpaguesve është Zyrë me raportim të drejtpërdrejt tek Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore, dhe i vendosur në Drejtorinë e Përgjithshme.
2. Avokati i Tatimpaguesve, në ushtrimin e autorizimeve dhe përgjegjësi të tij/saj, do të ndihmohet nga një numër i mjaftueshëm i zyrtarëve.



Neni 4

Fushëveprimi dhe Autoriteti i Avokatit të Tatimpaguesve

1. Në kryerjen e funksionit të tij, Avokati i Tatimpaguesve ka autoritetin që:
 - 1.1 Të monitorojë procedurat e zbatuara nga zyrtarët e ATK-së, me qëllim që të sigurohet respektimi i të drejtave të tatimpaguesve.
 - 1.2 Të shqyrtojë çdo kërkesë të tatimpaguesve, në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.
 - 1.3 Të kërkojë dhe të pranojë informata nga çdo zyrtar i ATK –së, lidhur me shqyrtimin e kërkesës së tatimpaguesit.
 - 1.4 Të kërkojë informata dhe dokumentacion nga tatimpaguesi, në lidhje me kërkesën dhe çështjen e ngritur nga ai.
 - 1.5 Të rekomandoj Drejtorin e Përgjithshëm, lidhur me veprimet që do të ndermirën nga zyrtarët e ATK-së.
 - 1.6 Të vendosë lidhur me heqjen e ndëshkimeve sipas Ligjit.
 - 1.7 Të identifikojë çështjet që kanë ndikim në të drejtat e tatimpaguesit dhe të kërkojë vëmendjen e menaxhmentit të lartë këto çështje.
 - 1.8 Të rekomandojë përmirësime ose ndryshime në Legjislacionin Tatimor, apo në procedura te brendshme të ATK-se lidhur me administrimin e tatimeve.
 - 1.9 Të jetë i përfshirë në të gjitha diskutimet për nisma dhe ndryshime të procedurave në ATK, me qëllim të përfaqësimit të interesave të tatimpaguesve.
 - 1.10 Të kryej çdo veprim tjetër për të cilin autorizohet nga Drejtori i Përgjithshëm.
2. Avokati i Tatimpaguesve nuk është zëvendësimit për procedurat e rregullta ose procedurën e ankesave.
3. Nëse tatimpaguesi pretendon se procedurat lidhur me vendosjen e çështjes së konstatuara nga tatimpaguesi nuk janë zbatuar drejt ose në kohë, Avokati i Tatimpaguesve është i autorizuar që të shqyrtojë çdo kërkesë të tatimpaguesit dhe të rekomandojë veprime për zgjidhjen e çështjes.
4. E drejta për t'ju drejtuar Avokatit të Tatimpaguesve sipas paragrafit 3 të këtij Neni, lind vetëm pasi të jenë ndjekur procedurat e rregullta në drejtoritë rajonale/DTM apo departamentet përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme, që kanë nën juridiksion shqyrtimin/administrimin e procedurës lidhur me çështjen e kontestuar. Afati për t'iu drejtuar Avokatit të Tatimpaguesve sipas këtij neni është 90 ditë nga data e vendosjes së çështjes së kontestuar.
5. Avokati i Tatimpaguesve, nuk shqyrton kërkesat e tatimpaguesve lidhur me çështjet për të cilat ka filluar hetimi tatimor ose për të cilat i është drejtuar gjykatës ose organit tjetër kompetent.

Neni 5

Rregullat dhe Procedurat e shqyrtimit të kërkesës nga Avokat i Tatimpaguesve

1. Ashtu siç është përcaktuar më këtë Rregullore, çdo tatimpagues ose grup tatimpaguesish, që pretendojnë së u janë shkelur të drejtat apo interesat e tyre të ligjshme, kanë të drejtë ta njoftojnë Avokatin e Tatimpaguesit dhe të kërkojnë ndërhyrjen e tij për zgjidhjen e çështjes së kontestuar apo rregullimin e gjendjes, lidhur me të drejtën e shkelur ose të mohuar.



2. Për njoftimet ose kërkesat drejtuar Avokatit të Tatimpaguesve, nuk kërkohet formë e caktuar, por ato duhet të shprehin qartë objektin e njoftimit/kërkesës dhe mund të dërgohen në formë fizike ose elektronike.
3. Çdo pretendim i tatimpaguesit për shkelje të të drejtave të tij, duhet të adresohet në emër të Avokatit të Tatimpaguesve. Kërkesa mund të dorëzohet drejtpërdrejt në Zyrën e Avokatit të Tatimpaguesve apo në zyrat e drejtorive rajonale.
4. Kur tatimpaguesi konteston vendimin e Departamentit të Ankesave(DA), lidhur me çështjen e përcaktuar ne paragrafin 3 të Nenit 4 të kësaj Rregulloreje, e drejta për t'iu drejtuar Avokatit të Tatimpaguesve lind pasi që të ketë kaluar afati ligjor (30 ditë) për kontestim të vendimit të DA-s në Gjykatën Themelore por jo me gjatë se 90 ditë nga data e pranimit të vendimit nga DA. Gjithashtu, për t'u marrë në shqyrtim kërkesa nga Avokati i Tatimpaguesve, kërkohet që tatimpaguesi të dëshmojë se nuk ka iniciuar kontest në Gjykatën Themelore kundër vendimit të DA-së.
5. Pasi që është paraqitur njoftimi ose kërkesa e tatimpaguesit, Avokati i Tatimpaguesve fillimisht do të vendosë lidhur me pranimin apo mos pranimin e kërkesës për shqyrtim.
6. Në rast se Avokati i Tatimpaguesve, vlerëson të mos pranojë çështjen në shqyrtim, atëherë njofton tatimpaguesin për arsyen e mos shqyrtimit ose udhëzon tatimpaguesin për veprime të mëtutjeshme.
7. Në rast se Avokati i Tatimpaguesve, pranon çështjen në shqyrtim, bazuar në autorizimet e dhëna, ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për hetimin dhe shqyrtimin e kërkesës së tatimpaguesit.
8. Avokati i Tatimpaguesve duhet ta shqyrtojë kërkesën dhe ta njoftoj tatimpaguesin brenda 15 ditë pune, nga dita e pranimit të kërkesës. Përfundim nga kjo, në rastet kur duhet të kërkohen informata shtesë nga tatimpaguesi apo zyrtarët e ATK-së, shqyrtimi i kërkesës dhe njoftimi për tatimpaguesin duhet behët brenda 30 ditë pune, nga dita e pranimit të kërkesës.
9. Pas shqyrtimit të kërkesës së tatimpaguesit, Avokati i Tatimpaguesve lëshon njoftim për tatimpaguesin ose rekomandim për ATK-në.
10. Rekomandimi i lëshuar nga Avokati i Tatimpaguesve mund të jetë :
 - 10.1 Rekomandim për të kryer një veprim të caktuar procedural, i cili nuk është ndërmarr më parë apo nuk është zbatuar drejt, apo
 - 10.2 Rekomandim për anulimin e një vendimi dhe rishqyrtim të çështjes së kontestuar.
11. Rekomandimi i Avokatit të Tatimpaguesve sipas paragrafit 10 të këtij neni, duhet të zbatohet brenda 15 ditë pune, si dhe brenda këtij afati duhet të njoftohet Avokati Tatimpaguesve dhe tatimpaguesi për zbatimin e rekomandimit.
12. Shërbimet e Avokatit të Tatimpaguesve në mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tatimpaguesve janë pa pagesë.



Neni 6
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi nga data e nënshkrimit dhe shfuqizon çdo dokument tjetër të nxjerr me parë lidhur me Avokatin e Tatimpaguesve.

Data: 24/12/2018

Sakip Imeri


Drejtor i Përgjithshëm i ATK

